



Duke u mbështetur në nenin 40. Paragrafi 40.2 nën a) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040, nenit 40 nën pikën a) të Statutit të Komunës së Klinës, me kërkesën e anëtarëve të Komisionit për Draft-hartimin e Plotësim-ndryshimeve të Rregullores për bashkëpunimin e Komunës me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e Komunës së Klinës, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e III-te të rregullt për vitin 2020, të mbajtur më 15.05.2020, mori këtë:

V E N D I M

Për vënie në Diskutim Publik Draft-plotësimin dhe -ndryshimin të Rregullores për bashkëpunimin e Komunës me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e Komunës së Klinës/janar /2015/

I

Miratohet vendimi për vënien në diskutim publik të Draft-ndryshimeve dhe plotësimeve të Rregullores për bashkëpunimin e Komunës me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e Komunës së Klinës/janar /2015/.

II

Vënia në Diskutim publik e kësaj Projekt-Rregulloreje bëhet me qëllimin e dhënies së kontributit nga institucionet, qytetarët dhe ekspertët e fushës përkatëse, në mënyrë që e njëjta të jetë sa më funksionale nga subjektet implementues dhe të tjerët.

III

Vendimi është i plotfuqishëm që nga dita e miratimit në Kuvendin e Komunës dhe 7 ditë pas publikimit në faqet e komunës.

Vendimi është transparent përmes: Tabelës së shpalljeve dhe Zyrës për Inform të Komunës së Klinës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01 Nr. 06-10041 /2020
Klinë, me 21.05 /2020

